



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BULQIZE
KESHILLI BASHKIAK**

Adresa: Lagja Minatori Bulqize tel +35521922694 email: Bashkia .Bulqize @bulqiza.gov.al

V E N D I M

Nr. 15 date 24 / 02 / 2017

PËR

MIRATIMIN E FONDIT PER NDIHME FINANCIARE PER RAST FATKEQESIE (DEMTIM SHTEPJE NGA ZJARRI) TE QYTETARIT FISNIK CAMI ,SI ME POSHTE:

Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ne ligjin nr.9936,date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit ne Republiken e Shqiperise" ne ligjin nr.10487,date 05.12.2011" Per Buxhetin e Shtetiti 2012" si dhe ne zbatim te ligjit 10296,date 08.07.2010 Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" si dhe Udhezimin nr.30,date 27.12.2011 "Per Menaxhimin e Akteve dhe mjeteve Monetare ne Njesine e Sektorit Puplik" vkm NR. 329 DATE 16.05.2012 "Per kriteret e dhenies se ndihmes shteterore financiare per te perballuar demet e shkaktuara ne ndertesa e pajisje",pika III,1,2,3.
Keshillit Bashkiak ne mledhjen e tij te dates 24.02.2017 pasi diskutoi dhe analizoi rreth projektit te paraqitur nga Drejtoria e Sherbimeve ne Bashki me 14 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim:

V E N D O S I:

- 1-Te miratoje dekomentacionin tekniko-ligjor te shtetasit **Fisnik Cami**.
- 2-Te akordoje nga fondi i vecante i Bashkise nje ndihme financiare te menjehershme prej 100.000 (njqind mije) leke.
 - Te pakesohet fondi reserve: Gr.00-Kap.01-Tit. 01110-Art.604 me Shumen 100.000 (njqind mije). leke.
 - Te shtohet fondi I emergjences civile: Gr.00-Kap.01-Tit.01110-Art.602 me Shumen 100.000 (njqind mije) leke.
- 3-Per mungese fondesh nga Buxheti I Bashkise Bulqize,per te bere kompensimin e plote te vleres se demeve te shkaktuara nga djegja, dosja nepermjet Institucionit te Prefektures ti percillet Drejtorise se Pergjithshme te Emergjencave Civile,duke i kerkuar kesaj te fundit kompensimin e vleres se demeve te shkaktuara sipas VKM 329,Date 16.05.2012.

Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Diber.

PER KESHILLIN BASHKIAK

**SEKRETARI
Agim TUCI**



**KRYETARI
Gazmend KENGA**